


# Raportu Vjetor 2012



“Mbi Aktivitetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”



## PËRMBAJTJE

- Mesazh përshëndetës i Kryetarit të Këshillit Administrativ të ISSH-së
- Mesazh përshëndetës i Drejtores së Përgjithshme të ISSH-së
- Profili i Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Struktura administrative e Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Legjislacioni
- Marrëdhënie ndërkombëtare
- Përfitime
- Kontribute
- Zhvillimi i burimeve të informacionit
- Investime
- Arkivi Qendror i Sigurimeve Shoqërore
- Aktiviteti financiar
- Informimi dhe marrëdhëniet me publikun
- Administrimi i burimeve njerëzore

## MESAZH PËRSHËNDETËS I KRYETARIT TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË ISSH-SË

### I nderuar lexues!

Modernizimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve ka qenë në përputhje me sfidat e qeverisë shqiptare, për të rritur të gjitha kapacitetet institucionale në sigurinë financiare të skemës dhe në shërbimin në kohë. Më lejoni që të theksoj se, pavarësisht vijimit të vështirësive financiare në të gjithë rajonin e më gjerë, Qeveria Shqiptare mbajti premtimin për rritjen e pensioneve. Kështu, edhe viti 2012 vijoi me rritjen në masën 5% për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare në fshat, si dhe me rritjen 4% për të gjitha pensionet e parakohëshme e suplementare të ushtarakëve, punonjësve të policisë së shtetit, pilotëve fluturues, detarëve, punonjësve të ndërmarrjeve ushtarake dhe ish-punonjësve të nëntokës.

Unë konstatoj, me kënaqësi, se ISSH ka vijuar të hedhë hapa të rëndësishëm në drejtim të fuqizimit të qëndrueshmërisë financiare të skemës, si dhe në dhënien e përfitimeve të drejta, duke nxjerrë jashtë nga skema çdo përfitues të pamërituar, si dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimit. Duhet theksuar komunikimi që ka patur ISSH me shqiptarët kudo që ndodhen, në mënyrë që ata të mbeten pjesë e kontributit dhe përfitimit në skemën e sigurimeve shoqërore, hap ky që ka siguruar një numër në rritje të tyre.

Në rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së duhet vlerësuar ajo ç'ka bërë ISSH për përafrimin e legjislacionit me vendet anëtare dhe me lidhjen e marrëveshjeve bilaterale në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të punonjësve shqiptarë, kudo që ata punojnë e jetojnë. Janë vlerësuar maksimalisht re-komandimet e Nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit, duke e bërë ISSH-në një institucion transparent me partnerët dhe një model integruar drejt BE-së.

Dëshiroj të përshëndes drejtuesit dhe specialistët e ISSH-së, për përpjekjet e tyre për të qenë çdo ditë e më shumë pranë qytetarëve, duke bërë që besimi i tyre në skemën e sigurimeve shoqërore të vijë gjithnjë e në rritje.

**Përshëndes drejtuesit dhe specialistët e ISSH-së, për afrimin çdo ditë e më shumë të këtij institucioni me qytetarët.**



**Ridvan BODE**  
Kryetar i Këshillit Administrativ të ISSH-së



## MESAZH PËRSHËNDETËS I DREJTORES SË PËRGJITHSHME TË ISSH - së

### I dashur lexues,

Me kënaqësi të veçantë po e hap edhe këtë vit Raportin Vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të Shqipërisë. Jam e bindur se në faqet e tij do të gjeni jo vetëm një analizë të qartë të zhvillimeve ekonomike e financiare të vitit të shkuar, por edhe një pasqyrë të punës së ISSH-së, për përmbushjen e detyrave ligjore dhe zhvillimin e angazhimeve të saj institucionale. Duke mos synuar të bëj një përmbledhje të plotë dhe në pamundësi për të realizuar brenda kësaj hapësire të shkurtër prezantuese një përmbledhje të hollësishme të të gjitha çështjeve të trajtuara, dëshiroj të paraqes në vijim disa prej mesazheve kryesore të raportit:

Gjatë vitit 2012, informatizimi i sistemit ka përfshirë plotësisht procesin e punës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke rritur akoma më shumë komunikimin online qytetarëve për çdo kërkesë të tyre. Falë këtij procesi, është shkurtuar koha që nevojitet për lidhjen e përfitimeve nga aplikuesit, si dhe marrja e çdo dokumenti të kërkuar nga qytetarët për nevoja të ndryshme. Ndërsa mbi 172 mijë pensionistë kanë marrë shërbimin online të pagesës së pensioneve, proces ky që pritet të përfundojë me shërbimin online për të gjithë pensionistët në mbarë vendin.

Ndërkohë, në 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore u transferua programi i informatizuar dhe tashmë çdo kandidat, që aplikon për përfitime dhe që një pjesë të periudhës kontributive e ka patur në ish-kooperativat bujqësore dhe si i vetëpunësuar në bujqësi nga viti 1993 deri më 2012, pajiset në kohë rekord, në rrugë elektronike, me vërtetimin e nevojshëm.

Nisja nga puna e Arkivit të centralizuar të sigurimeve shoqërore na ka dhënë mundësinë që të mbledhim nën administrimin tonë të gjithë dokumentet kontributive, duke na afuar edhe më shumë me qytetarët, në mënyrë që ata të marrin shërbimin në kohën e duhur dhe me pensione të merituar. Gjatë këtij procesi ISSH ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet e Posta Shqiptare sh.a, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Bankat e nivelit të dytë dhe Zyrat e Gjendjes Civile. Gjithashtu, gjatë vitit të shkuar, ne kemi arritur të aplikojmë në kohë çdo ndryshim në legjislacion dhe në rritjen e të ardhurave nga pensionet. Vlen të përmendim faktin se, në vitin 2012, drejt buxheteve familjare, pas rritjes së masës së përfitimeve nga skema e detyrueshme dhe suplementare, u transferuan 88,141.2 milionë lekë.

Mbështetur në një dinamikë të gjerë ndryshimesh stafi i ISSH-së ka synuar që përmes punës së përditshme të shtojë transparencën me kontribuesit dhe përfituesit e skemës, të japë informacion në kohë reale për gjithçka ndodh përse i përket marrëdhënies mes qytetarëve dhe ISSH-së. Këto hapa dhe largimi nga skema i cilitdo që kishte marrë përfitim të pamërituar kanë bërë të mundur rritjen e besimit të gjithësejçilit në skemën aktuale të pensioneve.

Duke vijuar me rëndësinë sociale që ka për qytetarët sigurimi i pensionit, ka patur një vlerë të rëndësishme publikimi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në mediat e shkruara dhe vizive i mundësive dhe favoreve që paraqiste sigurimi shoqëror i fermerëve.

**Ne do të punojmë gjithmonë e më shumë në drejtim të rritjes së besimit të qytetarëve ndaj skemës së sigurimeve shoqërore.**



**Vjollca BRAHO**  
Drejtoreshë e Përgjithshme, ISSH



Objektiv i rëndësishëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka qenë edhe përmirësimi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, për rritjen e hapësirës ligjore dhe administrative për mbrojtjen dhe mbulimin e emigrantëve nga skema e sigurimeve shoqërore, si dhe nxitjen e intensifikimin e punës për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mbrojtjes sociale.

Unë dhe stafi që drejtoj jemi të bindur se, informatizimi i të gjitha të dhënave për çdo kontribut të derdhur si dhe dhënia e çdo përfitimi në mënyrë të informatizuar, do të ofrojë gjithnjë e më shumë qytetarët ndaj skemës, duke na dhënë besim për çdo hap që kemi ndërmarrë.

## PROFILI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion që realizon të drejtën e shtetasve për mbrojtje shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Ai u krijua në Qershor të vitit 1992, me Vendim të Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>, për të administruar sistemin e sigurimeve shoqërore. Skema aktuale e sigurimeve të detyrueshme shoqërore në Shqipëri filloi në vitin 1993 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"<sup>2</sup>. Ajo është një skemë jo fitimprurëse, e ndërtuar mbi parimin "pay-as-you go", parimin e vetëpërgjegjesisë së individit për rrisqet e së ardhmes dhe parimin e solidaritetit midis brezave.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, shtetëror e i pavarur dhe drejtohet nga një Këshill Administrativ tripalësh, me përfaqësues të Qeverisë<sup>3</sup>, të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Aktivitetin e tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore e realizon nëpërmjet zyrave rajonale dhe agjensive lokale, që shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë.



<sup>1</sup> VKM nr.249, datë 5.6.1992 "Për krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore"

<sup>2</sup> Ligji hyri në fuqi më 1 Tetor 1993

<sup>3</sup> Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Statistikave

## KËSHILLI ADMINISTRATIV ISSH

### KRYETAR



**Ridvan BODE**  
Ministër i Financave

### NËNKRYETARË



**Gëzim KALAJA**  
Bashkimi i Sindikatave  
të Pavarura të Shqipërisë



**Ismail VAROSHI**  
Konfederata e Organizatave  
të Punëdhënësve

### ANËTARË



**Kastriot SULKA**  
Zëvendësministër i Punës, Çështjeve  
Sociale dhe Shanseve të Barabarta



**Elvana HANA**  
Drejtoreshë Përgjithshme  
ISKSH



**Ines NURJA**  
Drejtoreshë Përgjithshme  
INSTAT



**Ylli DYLGJERI**  
Drejtor  
Ministria Ekonomisë



**Avenir KIKA**  
Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë



**Eshtem GRACI**  
Unioni i Sindikatave të  
Punonjësve të Shqipërisë



**Kolë NIKOLLAJ**  
Konfederata e Sindikatave  
të Shqipërisë



**Bashkim SALA**  
Bashkimi i Organizatave të  
Biznesit Shqiptar


## ANËTARËT E BORDIT DREJTUES TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

<b>Vjollca BRAHD</b>	Drejtoare e Përgjithshme
<b>Ali EMINI</b>	Zv/Drejtor i Përgjithshëm
<b>Astrit HADD</b>	Zv/Drejtor i Përgjithshëm
<b>Teuta MUÇD</b>	Drejtoare, Drejtoria e Kontributeve
<b>Lindita GJINAJ</b>	Drejtoare, Drejtoria e Financës
<b>Elvin NURIU</b>	Drejtor, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm
<b>Kreshnik BRASHA</b>	Drejtor, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
<b>Mirela SELITA</b>	Drejtoare, Drejtoria Ligjore
<b>Sabah GOCI</b>	Drejtor, Drejtoria e Përfitimeve
<b>Pranvera KETA</b>	Drejtoare, Drejtoria e Arkivës
<b>Agim BAÇI</b>	Drejtor, Drejtoria e Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun
<b>Kujtim HOXHA</b>	Drejtor, Drejtoria e Auditit dhe Menaxhimit të Riskut





# STRUKTURA ORGANIZATIVE E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE



## LEGJISLACIONI

### Ligje

- Ligji nr. 23/2012, datë 01.03.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", "i ndryshuar", duke parashikuar një dispozitë të re në Kodin Penal, me titull "Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore".

### Vendime të Këshillit të Ministrave

#### ▪ Në fushën e Përfitimeve

- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 387, datë 27.06.2012 "Për rritjen e pensioneve". Pjesë e këtij Vendimi është edhe rritja e pensioneve suplementare dhe trajtimeve të veçanta;
- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 874, datë 19.12.2012 "Dhënie asistencë ekonomike, të menjëhershme, personave që përfitojnë pension".

#### ▪ Në fushën e Kontributeve

- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 414, datë 27.06.2012 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.07.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

### Rregullore

- Rregullore e ISSH-së, datë 20.01.2012 "Për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave personale në sistemin informatik".



## MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, gjatë vitit 2012, ka punuar për të zhvilluar më tej marrëdhëniet me institucionet homologe dhe realizimin e marrëveshjeve bilaterale për mbrojtjen shoqërore.

- Ka vazhduar zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për Mbrojtjen Shoqërore, duke realizuar kështu të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe turq për sigurimet shoqërore. Gjatë vitit të shkuar janë ndjekur rreth 100 procedura, në zbatim të Marrëveshjes dhe në përputhje me rregullat e vendosura në Marrëveshjen Administrative. Deri tani janë realizuar 450 procedura në zbatim të saj.
- Për të qënë sa më pranë emigrantëve tanë në Itali, në mungesë të Marrëveshjes për "Mbrojtjen Shoqërore" midis dy vendeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka çuar më tej bashkëpunimin me Patronatet italiane. Në shkurt 2012, pranë ambienteve të ISSH-së, u realizua trajnimi i operatorëve që do të punojnë në tre sportelet e para që Patronati ACLI (Shoqata Kristiane e Punëtorëve Italiane) ka hapur në Milano, Firenze dhe Savona. Në këto tri sportele shërbimi, emigrantëve po iu ofrohet informacioni i detajuar për legjislacionin shqiptar për mbrojtjen sociale dhe në veçanti në fushën e sigurimeve shoqërore;
- Në maj të vitit të kaluar, në Romë, Itali, u zhvillua Kongresi i Patronatit ACLI, ku mori pjesë dhe një delegacion i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme, znj. Vjollca Braho. Në fjalën përshëndetëse të znj. Vjollca Braho, u vlerësua ky bashkëpunim dhe rezultatet në kuadër të informimit të emigrantëve shqiptarë për realizimin e të drejtës për mbrojtje sociale;
- Patronati ACLI ngriti në nëntor 2012 zyrën e tij në Tiranë. Falë këtij bashkëpunimi, INAS mori përsipër që të asistojë falas në dhënie të informacionit për mbi 500 mijë emigrantë legalë, që ndodhen sot në territorin Italian, nëpërmjet 820 zyrave në të gjithë territorin e Italisë.
- Janë zhvilluar tani tri raunde bisedimesh për marrëveshjen e mbrojtjes shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë. Raundi i fundit i negociatave u zhvillua në Tiranë, nga data 17 - 20 Prill 2012. Gjatë bisedimeve intensive palët ranë dakord dhe përfunduan dhe Marrëveshjen Administrative, në zbatim të Marrëveshjes bazë për mbrojtjen shoqërore;
- Nga data 27 - 29 Mars 2012 në Tiranë u zhvillua raundi i dytë i negociatave midis përfaqësuesve të Republikës të Shqipërisë dhe Maqedonisë për marrëveshjen në fushën e mbrojtjes shoqërore;
- Në 21 - 25 Maj 2012, në Pragë, u zhvillua raundi i parë i negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë;
- Në datat 6 - 9 Nëntor 2012 filluan negociatat për realizimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Luksemburgut;
- Nga 3 - 7 Dhjetor 2012, në Bukuresht, u zhvillua raundi i fundit i negociatave për marrëveshjen bilaterale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Rumanisë. Procesi i negociatave për nënshkrimin e një marrëveshjeje të re midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Rumanisë, synon zëvendësimin e marrëveshjes së vjetër të ratifikuar më 03.05.1961, por që zhvillimet e reja legjislative e kanë bërë praktikisht të pazbatueshme.



## PËRFITIME

Pensionet janë pjesë përbërëse e mbrojtjes sociale të një vendi dhe element i pazëvendësueshëm i saj. Në vendin tonë, me pensione trajtohen aktualisht rreth 19% e popullsisë, me tendencë të qarta drejt rritjes së numrit të tyre. Ndërkohë, praktikat e kursimeve të popullatës për efekt të sigurimit të të ardhurave personale për moshën e tretë, tek ne, për arsye e motive të ndryshme kanë qenë mjaft të kufizuara. Rëndësia e sistemit të pensioneve do të vazhdojë të vijë në rritje, ndoshta edhe me largimin e fëmijëve nga prindërit, si pasojë e migrimeve të brendshme e të jashtme, por edhe të mendësive të reja që po zenë vend në psikologjinë dhe në ekonominë e familjeve shqiptare.

Sistemi aktual i pensioneve në Shqipëri u vendos me Ligjin nr. 7703, date 11.05.1993: "Mbi Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Ky sistem është i mbështetur në dy kolona: në atë të detyrueshme dhe në kolonën suplementare, e cila momentalisht nuk paraqitet ende e zhvilluar. Kolona e sigurimit të detyrueshëm mbulon të punësuarit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë. Periudha e sigurimit hyn në fuqi në datën kur personi fillon ligjërisht aktivitetin ekonomik dhe mbaron në datën kur e mbyll atë. Për të fituar të drejtën e pensionit, personat detyrimisht duhet të kontribuojnë në degën përkatëse, gjatë një periudhe sigurimi të përcaktuar. Periudha e sigurimit përfshin kohën kur janë paguar kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore.


Përfitimet, në varësi të kohëzgjatjes së tyre ndahen në:

### A. Përfitime afatgjata

Periudha e dhënies së këtyre përfitimeve zgjat mbi 1 vit. Në këto kategori përfitimesh përfshihen pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare. Aktualisht, skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore vazhdon të trajtojë pensionet urbane dhe pensionet rurale<sup>4</sup>, këto të fundit me tendencë uljeje në numër.

Për vitin 2012, skema e detyrueshme ka trajtuar me përfitime afatgjata të të gjitha llojeve 554,102 persona, nga këto 399,959 pensione urbane dhe 154,143 pensione rurale.

- *Pensionet e pleqërisë* përbëjnë grupin më të madh të përfituesve, me rreth 78.3% të tyre, ose 433,847 pensione, duke përfshirë të dy llojet e pensioneve urbane dhe rurale, prej të cilëve 296,076 pensione pleqërie urbane dhe 137,771 pensione pleqërie rurale;
- *Pensionet e invaliditetit* zenë rreth 11,2 % të pensioneve gjithsej ose 61,813 persona, prej të cilëve 55,245 invalidë urbanë dhe 6,853 invalidë ruralë;
- *Pensionet familjare* përbëjnë 10.5 % të pensioneve gjithsej ose 58,157 pensione, prej të cilave 48,638 pensione familjare urbane dhe 9,519 pensione familjare rurale.



<sup>4</sup> Pensionet rurale quhen ndryshe dhe pensione fshati. Pensionet e fshatit quhen aktualisht kështu duke patur parasysh vendin e punës ku personat kanë punuar para vitit 1991, në ish-kooperativat bujqësore.

## Politikat e zbatuara në fushën e pensioneve për vitin 2012

Gjatë vitit të kaluar, në kuadër të programit të Qeverisë për përmirësimin e nivelit të jetesës së pensionistëve, masa mujore dhe të ardhurat mujore të pensionistëve pësuan sërish rritje. Me VKM nr. 387, datë 27.06.2012 "Për rritjen e pensioneve" u rritën:


- Në masën 4% pensionet *urbane* të pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare;
- Në masën 5% pensionet *rurale* të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare.

Si rezultat i këtyre rritjeve, kanë përfituar rreth 581,000 pensionistë, me një efekt financiar vjetor prej 1,602 milionë lekë. Duhet theksuar se rritjet vjetore të pensioneve kanë qenë vazhdimisht më të larta se inflacioni.

### Niveli minimal për pensionet e pleqërisë, urbane dhe rurale, si dhe kompensimet që kanë përfituar pensionistët sipas të gjitha Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për vitet 2006-2012

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Të ardhurat minimale për pensionet Urbane	10,000	10,410	11,275	12,226	12,840	13,267	13,712
Pensioni minimal i pleqërisë Urban	8,240	8,650	9,515	10,276	10,690	11,117	11,562
Kompensimi i energjisë elektrike	350	350	350	350	350	350	350
Kompensimi i bukës	150	150	150	150	150	150	150
Kompensimi VKM nr. 401	500	500	500	500	500	500	500
Kompensimi VKM nr. 763	760	760	760	760	760	760	760
Kompensimi VKM nr. 415				190	190	190	190
Kompensimi VKM nr. 474					200	200	200
Të ardhurat minimale për pensionet Rurale	4,310	5,410	6,090	7,234	7,870	8,358	8,731
Pensioni minimal i pleqërisë Rural	4,110	4,520	5,200	6,344	6,980	7,468	7,841
Kompensimi i energjisë elektrike	200	200	200	200	200	200	200
Kompensimi VKM nr. 17		690	690	690	690	690	690

### Ndryshimet me tendencë në rritje të të ardhurave minimale në vite për pensionet urbane dhe rurale




## B. Përfitime afatshkurtra

Skema e detyrueshme, veç pensioneve, mbrohen me të ardhura dhe persona të tjerë të siguruar në rastin e pakësimit të tyre si rezultat i:

- *Paaftësisë së përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes:* periudha e përfitimit zgjat nga 15 ditë deri në 6 muaj, si pasojë e sëmundjes së përgjithshme dhe deri në 1 vit, si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundjeve profesionale. Në këto përfitime përfshihen: të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga sëmundje të përgjithshme dhe të ardhura për paaftësi të përkohëshme nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- *Paaftësisë së përkohëshme nga sëmundjet e përgjithshme:* për vitin 2012 janë trajtuar me paaftësi të përkohëshme në punë nga sëmundje të përgjithshme 2,779 përfitues, nga të cilat 901 në sektorin buxhetor, 162 përfitues në sektorin jobuxhetor dhe 1,716 përfitues në firmat private;
- *Paaftësisë së përkohëshme nga aksidenti në punë dhe sëmundjet profesionale:* të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë apo sëmundjet profesionale jepen në momentin kur vërtetohet aksidenti apo sëmundja profesionale, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Për vitin 2012 janë trajtuar me paaftësi të përkohëshme në punë, si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundjeve profesionale 47 përfitues, nga të cilët 11 përfitues në subjektet buxhetore dhe 36 përfitues në firmat private;
- *Barrë lindjes:* përfitimi për barrë lindje i jepet një gruaje të siguruar, lidhur me barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ka jo më pak se 12 muaj sigurim, për çdo rast barrë lindjeje. Për vitin 2012 janë trajtuar me përfitim për barrë lindjeje 11,990 përfitues, nga të cilat 1,875 në subjektet buxhetore, 131 në subjektet jobuxhetore, 3,146 në firmat private, 1,025 të vetëpunësuarit në qytet dhe 4,898 përfitues nga të vetëpunësuarit në bujqësi;
- *Papunësisë:* përfitimet që rrjedhin nga kjo degë sigurimi jepen nga stukturat e veçanta të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

**Përfitues afatshkurtër sipas degëve të përfitimit gjatë vitit 2012**



## C. Përfitimet suplementare

Sigurimi suplementar është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore.

Aktualisht ekzistojnë tri skema:

- Skema e sigurimit shtetëror suplementar;
- Skema e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve;
- Skema e trajtimeve të veçanta.

Qëllimi i skemave të sigurimit suplementar është dhënia e përfitimeve suplementare, si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror për personat që me ligje deklarohen subjekte të skemave respektive.


Në skemat e sigurimit suplementar dhe të trajtimeve të veçanta, gjatë vitit 2012 janë trajtuar gjithsej me përfitime rreth 29.448 persona, me një fond të programuar nga Buxheti i Shtetit prej 4,979 milionë lekësh, të cilët, të ndarë sipas skemave paraqiten:

- Në skemën e sigurimit shtetëror suplementar janë trajtuar me përfitime 1,506 persona. Kjo skemë është e detyrueshme për sa i përket pjesëmarrjes në të, për kategoritë e përcaktuara me ligj;
- Në skemën e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve janë trajtuar me përfitime 0,377 persona. Kjo skemë tashmë funksionon sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSH", i ndryshuar, dhe trajton me përfitime suplementare ushtarakët e shërbimit aktiv të strukturave të përcaktuara në të. Skema financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributet e të punësuarve në strukturat ushtarake përkatëse;
- Në skemën e trajtimeve të veçanta për vitin 2012 janë trajtuar me përfitime 5,669 persona, nga të cilët:
  - ish-punonjës të nëntokës 3,698 persona;
  - trajtime të familjeve përfituese nga Statusi "Dëshmor i Atdheut" 378 familje;
  - ish-punonjës të ndërmarrjeve të industrisë ushtarake 712 persona;
  - pilotët fluturues në pension 264 persona;
  - ushtarakët detarë të nëndetësive në pension 68 persona;
  - 549 persona që përfitojnë nga Ligji nr. 10139, datë 15.05.2009 "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të Universiteteve, të Shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë".



Fondet e kësaj skeme përballohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit 85.5% dhe nga kontributet që derdhin personat e përfshirë në të në nivelin 14.5%.

### Përfitues në skemat suplementare gjatë vitit 2012





## KONTRIBUTE

Një ndër prioritetet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka qenë dhe mbetet realizimi i të ardhurave në fushën e kontributeve dhe rritja e numrit të kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore. Gjatë vitit 2012 puna është përqëndruar në përmbushjen e objektivave, ku si ndër më të rëndësishmit mund të veçojmë:

- Realizimin e treguesve të planifikuar për të ardhurat nga kontributet;
- Bashkëpunimin në vazhdimësi me organet tatimore për realizimin e të ardhurave të programuara nga subjektet në përgjegjësi të organeve tatimore;
- Rritjen e numrit të të siguruarve në skemën e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe në skemën e sigurimit vullnetar;
- Bashkëpunimin me organet tatimore për zbatimin e Ligjit të faljes dhe pakësimit të detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitore, i cili i shtriu efektet e tij deri në fund të muajit mars të vitit 2012;
- Grumbullimin, sistemimin dhe krijimin e bazës të të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi për periudhën 1993-2012;
- Realizimin e të ardhurave në fondin e sigurimeve shoqërore, për sigurimet shoqërore të detyrueshme dhe suplementare, me 49.322.2 milionë lekë, nga 50.767 milionë lekë të programuara, me një diferencë prej 1.444.8 milionë lekë ose 97.2%. Por, gjatë vitit 2012 janë mbledhur 925.2 milionë lekë më shumë se viti 2011;

### Të ardhurat e programuara dhe realizimi i tyre për vitin 2012

ne milione leke

	plan	fakt	ndryshimi	%
1 Nga subjektet juridike e fizike	47,604	45,738	-1,866	96.1
2 Të vetëpunësuar në bujqësi	2,550	2,009	-541	78.8
3 Sigurimi vullnetar	381	357	-24	93.7
4 Të ardhura të tjera	232	506	274	218.1
<b>Totali</b>	<b>50,767</b>	<b>48,609</b>	<b>-2,158</b>	<b>95.8</b>

#### ▪ Për sektorin e të vetëpunësuarve në bujqësi

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi për vitin 2012 u realizuan 84.9%, me një mosrealizim prej 386.3 milionë lekë. Këtu duhet theksuar se deri më datë 31.03.2012 i shtriu efektet Ligji nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", Ligj ky që favorizoi edhe të vetëpunësuarit në bujqësi, pasi lejonte pagesat e kontributeve pa kamatëvonesa. Ky Ligj dha influencë pozitive në rritjen e numrit të fermerëve të siguruar dhe në tejkalimin e të ardhurave të programuara nga të vetëpunësuarit në bujqësi, për tremujorin e parë të vitit 2012.

Në skemën e sigurimit shoqëror në zonat rurale, gjatë vitit 2012, janë vënë re disa fenomene negative, të cilat influencuan në mosrealizimin e të ardhurave të programuara të këtij viti, si:

- Personat me moshë të re, në zonat rurale, janë më pak të interesuar për sigurimin e tyre;
- Të gjithë ata që kanë plotësuar 35 vjet vjetërsi në punë nuk po e vazhdojnë sigurimin e tyre.

#### ▪ Për sektorin e sigurimit vullnetar

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve të personave të siguruar vullnetarisht, për vitin 2012, u realizuan në masë 93.9%, me një mosrealizim prej 23.3 milionë lekë.

Gjatë vitit 2012, në funksion të sigurimit vullnetar, është bërë një publicitet i vazhdueshëm si brenda ashtu dhe jashtë vendit, veçanërisht për emigrantët në Itali. Në këtë kuadër, ka vazhduar bashkëpunimi me disa Patronate në Itali si "INAS CISL", "ACAI", "ACLI", "ENAS-UGL", në drejtim të përfshirjes së emigrantëve shqiptarë në skemën e sigurimit vullnetar dhe konfirmimin e periudhave kontributive.


Në skemën e sigurimit vullnetar, për vitin 2012, janë venë re disa faktorë, të cilët kanë influencuar në mosrealizimin e të ardhurave të programuara të këtij viti, ku mund të veçojmë:

- Moskthimin e një numri të konsiderueshëm emigrantësh, të përhershëm apo sezonalë, në atdhe. Edhe emigrantët e ardhur gjatë vitit 2012, janë siguruar vetëm për vitin korrent;
- Kategori të caktuar personash kanë synuar sigurimin vullnetar, vetëm për të plotësuar 15 vjet sigurim. Në këtë kategori përfshihen edhe emigrantët, të cilët kanë vjetërsi kontributive, në shtetet ku ata janë rezidentë.

### Ulja e normës kontributive dhe influenca në rritjen e të ardhurave

Reduktimi i masës së kontributeve për punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin, ka dhënë një ndikim pozitiv jo vetëm në rritjen e të ardhurave, por edhe në rritjen e numrit të të punësuarve në subjektet privatë juridikë e fizikë, si dhe në rritjen e numrit mesatar të kontribuesve për një subjekt.

#### Të ardhurat në total dhe ecuria e normës së kontributit



### Realizimi i numrit të kontribuesve

- Gjatë vitit 2012 numri mesatar i kontribuesve rezultoi 11.4% më i ulët se një vit më parë, ose rreth 84 mijë persona më pak;
- Në sektorin urban numri mesatar i kontribuesve pati një rritje prej 8,750 personash, ose 1.8 % kontribues më shumë se gjatë viti 2011;
- Influencën në mosrealizimin e numrit mesatar të kontribuesve e ka dhënë sektori rural, i cili pati një rënie prej rreth 93 mijë kontribuesish.



## Pasqyra e numrit mesatar të kontribuesve për vitin 2012

	numër mesatar viti 2012	në % ndaj totalit	numër mesatar viti 2011	në % ndaj vitit 2011
sipas subjekteve:	603,404	94.1	692,110	106.2
ndërmarrje buxhetore	138,232	18.9	139,177	104.7
ndërmarrje jobuxhetore	20,929	3	21,987	98.9
firma private	188,632	24.8	182,358	107.2
të vetëpunësuar	79,357	10.7	78,998	121.1
të vetëpunësuar në bujqësi	168,513	35.5	261,097	103.4
vullnetarisht	7,741	1.2	8,493	98
të siguruar nga shteti	33,394	3.8	27,669	92.8
me përfitim afatshkurtër	14,816	2.1	15,669	121.4
<b>Numri i kontribuesve</b>	<b>735,448</b>		<b>694,514</b>	<b>105.9</b>

### Për sektorin urban


- Për subjektet publike rezultuan 159,161 kontribues dhe numri mesatar i personave të punësuar në një subjekt publik arriti në 74.6, e barabartë kjo me numrin mesatar të personave të punësuar në një subjekt publik, në fund të vitit 2011;
- Për subjektet privatë gjatë vitit 2012 rezultuan 267,989 kontribues, nga 261,356 kontribues që ishin në vitin 2011, me një rritje prej 2.5% ose 6,633 kontribues më shumë, nga të cilët 6,274 kontribues në firmat private dhe 359 të vetëpunësuar. Kjo rritje u reflektua edhe në rritjen e numrit mesatar të personave të punësuar në një subjekt privat, i cili nga 3.4 gjatë vitit 2011, arriti në 3.5 të punësuar. Kështu numri mesatar i personave të punësuar në një firmë private nga 11.6 arriti në 12 të punësuar në një firmë private. Ndërsa numri mesatar i të vetëpunësuarve privatë në një subjekt rezultoi 1.3, e barabartë kjo me numrin mesatar të personave të vetëpunësuar, në një subjekt në fund të vitit 2011.

### Për të vetëpunësuarit në bujqësi

Gjatë vitit 2012 numri i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi, të llogaritur në vite njerëz kontribute rezultoi në 168,513 kontribues dhe krahasuar me vitin 2011 pati ulje me 35.5% ose 92,584 kontribues më pak. Ndërsa numri i të vetëpunësuarve fizikë të siguruar rezultoi 66,620 nga të cilët 49,518 ose 74.3% ishin të vetëpunësuar të zonës fushore dhe 17,102 ose 25.7% ishin të vetëpunësuar të zonës malore. Duke bërë një analizë të numrit të vetëpunësuarve fizikë të siguruar sipas grupmoshave, për vitin 2012, rezultuan se:

- Personat deri në moshën 30 vjeç zenë 11.6% të numrit të përgjithshëm të të siguruarve, ç'ka tregon se sigurimi i moshave të reja është në një numër relativisht të vogël dhe në këtë grup predominon sigurimi i grave për të përfituar barrë lindje;
- Personat e grupmoshës nga 31-60 vjeç zenë 79.2% të numrit të përgjithshëm të të siguruarve dhe në këtë grup mbizotëron sigurimi i kontribuesve në vazhdimësi të sigurimit dhe kontribuesve që kërkojnë të plotësojnë periudhën prej 35 vjet të siguruar, që nevojitet për një pension të plotë pleqërie.

Kontribues të vetëpunësuar në bujqësi sipas gjinisë dhe grupmoshës për vitin 2012




	15 - 20 vjeç	21 - 30 vjeç	31 - 40 vjeç	41 - 50 vjeç	51 - 60 vjeç	61 - 70 vjeç	mbi 71 vjeç
femra	653	6,065	7,708	9,864	15,148	1,196	1
meshkuj	44	986	4,208	7,810	8,011	4,916	10

### Për personat e siguruar vullnetarisht

Numri mesatar i kontribuesve gjatë vitit 2012 rezultoi në 7,741 persona të siguruar vullnetarisht dhe krahasuar me vitin 2011 pati ulje me 8.9% ose 752 kontribues më pak. Ndërsa numri fizik i kontribuesve në fund të vitit 2012 rezultoi me 4,484 persona të siguruar vullnetarisht. Duke analizuar grupmoshën e personave fizikë të siguruar vullnetarisht, rezultoi:

- Në numrin fizik të kontribuesve gjithsej, për vitin 2012, kontribuesit brenda vendit kanë zënë rreth 60% nga 58% që zinin në vitin 2011 dhe emigrantët kanë zënë rreth 40%, nga 42% që zinin në vitin 2011;
- Në numrin e personave të siguruar, që nga fillimi i skemës së sigurimit vullnetar, grupmoshat 18-30 vjeç përbëjnë 6.6% të saj, grupmosha 31-50 vjeç zënë 42.9% dhe grupmosha mbi 50 vjeç zë 50.5% të skemës së sigurimit vullnetar.



### Pakësimet e detyrimeve të prapambetura dhe efektet e zbatimit të ligjit të faljes

Gjatë vitit 2012, ISSH ka analizuar pakësimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve jobuxhetorë, të firmave private dhe të vetëpunësuarve nëpërmjet riinventarizimit të të gjithë subjekteve debitorë dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura, dhe në bashkëpunim me organet tatimore ka ndjekur efektet e zbatimit të Ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor", i cili i shtriu efektet e tij deri në fund të muajit mars të vitit 2012.



## Pasqyrë përbledhëse e pakësimit të detyrimeve gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2012

në milionë lekë

	Numri i subjekteve	Detyrime të shlyera gjithsej	Nga këto:	
			Kontribut	Kamatë
<b>Gjendja më 01.01.2012</b>	<b>838.0</b>	<b>536.4</b>	<b>505.0</b>	<b>31.4</b>
Shtesat e periudhës	0.0	0.0	0.0	0.0
Pakësimet e periudhës	579.0	153.7	153.3	0.4
<b>Gjendja më 31.12.2012</b>	<b>259.0</b>	<b>382.7</b>	<b>551.7</b>	<b>31.0</b>

Për periudhën Janar - Dhjetor 2012 janë pakësuar gjithsej 579 subjekte debitorë për shumën e detyrimeve të prapambetura prej 153.7 milionë lekë, nga të cilat 153.3 milionë lekë kontribute dhe 0.4 milionë lekë kamatëvonesa. Kryesisht, pakësimet kanë ardhur si rrjedhojë e riinventarizimit të të gjithë subjekteve debitorë dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura me një efekt në pakësimin e 551 subjekteve debitorë dhe për shumën e detyrimeve të prapambetura të tyre, prej 150.4 milionë lekë gjithsej.

### Baza e të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë koordinuar punën për krijimin e bazës së të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi për periudhën 1993 – 2012, të ndarë në bazën e të dhënave të periudhës 1993 – 2005, e cila është drejt përfundimit dhe bazën e të dhënave të periudhës 2006 – 2012, e cila ka përfunduar. Në të dyja bazat ka të dhëna analitike për rreth 519 mijë të vetëpunësuar në bujqësi, të cilët kanë prekur skemën e sigurimeve shoqërore gjatë këtyre viteve.



## ZHVILLIMI I BURIMEVE TË INFORMACIONIT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kuadër të informatizimit të mëtejshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore, gjatë vitit 2012, është angazhuar në një sërë detyrash dhe projektesh. Si rrjedhojë ka vazhduar puna për implementimin e të gjitha programeve që kanë filluar të ndërtohen, duke përcaktuar arkitekturën e këtij implementimi, nevojat për hardware dhe software, fazat që do të ndiqen, prioritetet për pjesë të veçanta të sistemit të integruar, koha për realizimin tyre dhe kostot përkatëse.

### Gjatë vitit 2012:

- Ka vazhduar puna për hedhjen e kartelave të pensioneve të të gjitha llojeve (urban/rural) në programin e hedhjes online të dosjeve të pensioneve (kartelave elektronike). Për këtë program është ndërtuar rrjeti i transmetimit online të të dhënave (data transmission) për DRSSH-të Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Vlorë, Shkodër, Berat, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Dibër. Aktualisht janë duke hedhur të dhënat në këtë program, që bazohet mbi web application, të 12 DRSSH-të. Ky program bën më efikas, veç të tjerash, dhe kontrollin për abuzimet me pensionet. Nga hedhjet e deritanishme janë kapur dosje të dubluara nëpër rajone, për të cilat është ngritur Komiteti Ad-Hoc, i cili është marrë me procedurat e mëtejshme me këto dosje. Implementimi i programit web application, i cili i merr të dhënat e përfituesve nga regjistri i shtetasve, ka nxjerrë në pah përfitimet e lidhura në mënyrë të padrejtë nga ndryshimet në moshë;
- Ka përfunduar programin e sistemit financiar. Për këtë është trajnuar personeli dhe pritjet të implementohet në të gjitha Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore (me konsulencë FASTECH). Në DRSSH-të po punohet tashmë me këtë program;
- Ka përfunduar programin e kalkulimit online të përfitimeve (konsulent INFO Soft), i cili do të bëjë të mundur që informacioni të mund të aksesohet në kohë reale;
- Portali i pagesave online është implementuar në pikat paguese të qyteteve Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë dhe në pesë pika paguese në DRSSH Tiranë. Me anë të këtij sistemi do të bëhen pagesat në kohë më të shpejtë dhe në mënyrë me efektive;
- Sistemi për menaxhimin e kontributeve. Gjatë vitit ka përfunduar programin e menaxhimit të kontributeve (konsulent FBS), i cili do të funksionojë në web application dhe është bërë trajnimi i personelit në ISSH. Me anë të këtij programi do të arrihet hedhja e kontributeve në një sistem të centralizuar.



## INVESTIME

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kuadër të modernizimit të punës, me mbështetje të Bankës Botërore, gjatë vitit 2012, përfundoi ndërtimin e Arkivit Qendror të sistemit të sigurimeve shoqërore, financuar nga kredia e BB, IDA dhe IBRD. Kjo godinë është ndërtuar duke u mbështetur në parametra bashkëkohorë, pajisur me të gjitha sistemet moderne të ajrit të kondicionuar, sistemit antizjarr me gaz, dhomë serverash, pajisje zyre dhe kompjuterike, të gjitha të reja. Sipërfaqja e truallit të dhënë nga Qeveria është 8 100 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e godinës 3 500 m<sup>2</sup>, e shtrirë në dy kate. Pjesa kryesore e Arkivit është parashikuar për ruajtjen e dokumentacionit të vjetërsisë në punë dhe dosjeve të përfitimit, si dhe zyrat dhe facilitetet për administratën. Në këtë Arkiv do të grumbullohen të gjitha dokumentat që kanë të bëjnë me vjetërsinë në punë dhe dosjet e përfitimit nga të gjitha DRSSH-të dhe arkivat shtetërore. Krahas grumbullimit të këtij dokumentacioni do të realizohet skanimi i dokumentave të vjetërsisë (regjistra, libra page, bordero, listëpagesa) dhe më pas këto dokumenta do të dixhitalizohen sipas alfabetit alfanumerik, me qëllim llogaritjen automatike të pensioneve dhe rritjen e transparencës për kontribuesit. Ndërtimi i këtij Arkivi kap koston e rreth 1.7 milionë dollarë amerikanë, ndërsa pajisja e tij me rafte moderne gjysëmatommatike për ruajtjen e dokumentacionit, rreth 950 mijë dollarë amerikanë. Gjithashtu, sistemi i kondicionimit, ruajtjes së lagështirës konstante, sistemit antizjarr me gaz, si dhe sistemi elektrik dhe furnizimi me energji ka kushtuar rreth 1.3 milionë dollarë amerikanë. Ky Arkiv është pajisur me hardware dhe software të rinj, ku përfshihen dhoma e serverave, serverat, storage dhe pajisjet e telekomunikacionit, skanerat specialë për skanim të të gjitha llojeve dhe tipeve të dokumentacionit, kompjuterat dhe softi për skanim, dixhitalizim dhe transmetim të dhënash, me një kosto prej rreth 1.4 milione dollarë amerikanë. Kostojat totale të këtij Arkivi është rreth 5.4 milionë dollarë amerikanë. Kemi kënaqësinë të theksojmë se ky projekt është cilësuar si një nga projektet më të sukseshme të BB në Shqipëri dhe me një impakt të madh për publikun dhe administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore.







Nëpërmjet programit të investimeve është synuar të përmirësohen kushtet e punës në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, si dhe Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore. Në këtë kuadër, mund të përmendim:

- Për vitin 2012, me financimet nga projektet e Bankës Botërore, kanë përfunduar punimet për rikonstruksionin e DRSSH-ve Lezhë, Fier, Vlorë dhe Durrës, me një vlerë totale prej 51 301 076.4 lekë me tvsh (vlera e kontratës);
- Gjithashtu, kanë përfunduar procedurat e prokurimit për rikonstruksionin edhe të 4 DRSSH-ve, Dibër, Kukës, Gjirokastër dhe Tiranë, me një vlerë totale prej 87 311 340 lekë me tvsh (vlera e kontratës);
- Për Godinën Qendrore të Arkivit të centralizuar të ISSH-së, janë kryer prokurimet për punime të brendshme, që kapin shifrën në total prej 1 613 285 Euro (pa tvsh).





## ARKIVI QENDROR I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2012, Arkivi Qendror i Sigurimeve Shoqërore ka përballuar një ngarkesë të madhe pune, duke synuar realizimin në kohë e me cilësi të të gjitha objektivave të ISSH-së. Në këtë kuadër, puna ka vijuar në 5 drejtime kryesore:

- Marrja në dorëzim e regjistrave themeltarë të vjetërsisë në punë të subjekteve shtetërore;
  - Certifikimi i regjistrave;
  - Hedhja e informacionit të regjistrave themeltarë në bazën e të dhënave;
  - Verifikimi dhe dhënia e vërtetimeve të vjetërsisë në punë;
  - Ndjekja e proceseve gjyqësore për vjetërsinë në punë dhe dhënia e përgjigjeve për kërkesat e ardhura nga avokatët, gjykatat dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore.
- Gjatë vitit 2012 u morën në dorëzim nga Arkivi i Përgjithshëm dhe u certifikuan fletë pas flete 4 518 rregjistra themeltarë të subjekteve shtetërore të rajoneve Vlorë, Dega Sarandë, Berat, Dibër, Elbasan, Fier, Kukës;
  - Filloi puna për përqëndrimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë në Arkivën e përqëndruar dhe për dixhitalizimin e dokumentacionit arkivor të periudhave të sigurimit. Në këtë kuadër, përfundoi procesi i krijimit të bazës së të dhënave të vjetërsisë në punë për kooperativat bujqësore;
  - Krahas procesit të informatizimit përfundimtar të të dhënave, gjatë viti 2012 u krye një volum i konsiderueshëm pune për dixhitalizimin e të dhënave të rregjistrave të vjetërsisë në punë të ish-ndërmarrjeve e subjekteve shtetërore, si dhe të ish-kooperativave bujqësore. Kështu në total, nga 11 093 rregjistra me të dhëna individuale, janë hedhur në një sistem paraparak 8 078 rregjistra;
  - Është realizuar përfundimi i hedhjes së të dhënave të regjistrave të KB, gjithsej 9 411 rregjistra, dhe tashmë çdo rajon administron dhe plotëson vërtetimet e vjetërsisë në punë për personat në Koop. Bujq. Përkatesë;
  - Gjatë viti të shkuar ka përfunduar hedhja e të dhënave të regjistrave të subjekteve shtetërore, si dhe është bërë transferimi i këtyre të dhënave në Rajonet Gjirokastër, Vlorë, Kukës dhe Dibër. Për Rajonin e Elbasanit hedhja e dytë e të dhënave të regjistrave të subjekteve shtetërore është realizuar në nivelin e 22% (janë hedhur 281 nga 1265), për Rajonin e Beratit procesi i kontrollit dhe komenteve të faqeve të regjistrave të subjekteve shtetërore është realizuar në nivelin e 67% (janë hedhur 483 nga 717), për Rajonin e Fierit procesi i kontrollit dhe komenteve të faqeve të regjistrave të subjekteve shtetërore është realizuar në nivelin e 92% (janë hedhur 1102 nga 1199);
  - Gjatë vitit 2012 DRSSH Durrës, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Elbasan, vazhduan procesin e hedhjes së të dhënave të regjistrave të subjekteve shtetërore.

Rajoni	Regjistra gjithsej	Të Hedhura	në %	Të Mbetura për t'u hedhur	në %
	(1)	(2)	(2)/(1)	(3)	(3)/(1)
Durrës	865	472	54.6	393	45.4
Elbasan	1,265	829	65.5	436	34.5
Korçë	1,161	710	61.2	451	38.8
Lezhë	645	368	57.1	277	42.9
Shkodër	868	338	38.9	530	61.1
Tiranë	2,228	1300	58.3	928	41.7
<b>Totali</b>	<b>7,032</b>	<b>4,017</b>		<b>3,015</b>	





## AKTIVITETI FINANCIAR

### 1. Plotësimi i objektivave kryesore financiare

Gjatë vitit që shkoi, veprimtaria financiare e ISSH-së është fokusuar në:

- Zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e pensioneve;
- Përmirësimin thelbësor të administrimit të sistemit të përfitimeve;
- Krijimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave si në fushën e përfitimeve, ashtu edhe në atë të kontributeve;
- Rritjen e cilësisë së administrimit të fondeve;
- Administrimin e pagesave;
- Evidentimin dhe marrjen e masave për minimizimin e risqeve dhe forcimin e kontrollit të përdorimit të fondeve.

Bashkërendimi i punës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, si dhe puna e strukturave të ISSH-së ka mundësuar:


- Sigurimin e fondeve të nevojshme dhe kryerjen e procedurave të rritjes dhe pagesës së pensioneve të shtuara nga data 01.07.2012 me 4% për qytetin, pensionet suplementare e trajtimet e veçanta financiare dhe me 5% për fshatin për rreth 583 mijë pensionistë e përfitues;
- Përmirësimin rrënjësor të punës dhe rritjen e efektivitetit dhe forcës së kontrollit në luftën kundër informalitetit në të gjithë procedurat e caktimit dhe pagimit të përfitimeve, veçanërisht në fushën e pensioneve, si nëpërmjet forcimit të kontrollit të brendshëm operacional, ashtu edhe nëpërmjet zbatimit të programeve informatike në këtë sistem. Në këtë kuadër, nga kontrolli i pagesave, janë zbuluar e arkëtuar mbi 39 milionë lekë dhe janë arkëtuar mbi 190 milionë lekë nga detyrimet debitore të krijuara si pasojë e zbulimit të përfitimeve të padrejta;
- Realizimin e të ardhurave të drejtpërdrejta për fondin e sigurimeve shoqërore në masën 97.4% ose 49,243.7 milionë lekë, nga 50,577 milionë lekë të programuara. Pavarësisht mosrealizimit të programit, në vitin 2012 janë mbledhur 847.7 milionë lekë më shumë se gjatë vitit 2011;
- Realizimin e tërheqjes së plotë të transfertës shtetërore, si për shumat e programuara për fondin e sigurimeve shoqërore, ashtu edhe për financimin e programeve të veçanta shtetërore, për sigurimet suplementare dhe për pagesat e tjera, në shumën prej 39,688 milionë lekë;
- Ndjekjen dhe respektimin çdo muaj të tavaneve të programuara të shpenzimeve dhe fondeve, si për transferta në buxhetet familjare ashtu edhe për shpenzimet e tjera. Në përfundim, shpenzimet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, suplementare, trajtimet dhe programet e veçanta, si dhe shpenzimet e administrimit në total u mbyllën në masën 99.6% ose nga 90,265 milionë lekë të programuara u realizuan me 89,859.7 milionë lekë, me një mosrealizim prej rreth 405.3 milionë lekësh;
- Realizimin në skemat e sigurimeve shoqërore të detyrueshme të shpenzimeve në masën 99.9%, me një mosrealizim prej 84.6 milionë lekësh, në programet financiare e kompensuese në masën 98.9%, me një mosrealizim prej 96.9 milionë lekë dhe në sigurimet suplementare e trajtimet e veçanta në masën 97.5% ose me një mosrealizim prej 126 milionë lekë;
- Që kostoja e administrimit të sistemit të zerë 1.95% të shpenzimeve nga deri në 5% të shpenzimeve që parashikohet si kufi nga ligji i sigurimeve shoqërore;
- Që punonjësit e shërbimit financiar, së bashku me punonjësit e përfitimeve dhe të administrimit të burimeve të informacionit (IT) të vazhdojnë procesin e implementimit të një sistemi të ri të informatizuar të pagesave të pensioneve, në të cilin deri në fund të vitit 2012 u përfshinë mbi 184 mijë përfitues;
- Rritjen e transfertave të përgjithshme në buxhetet familjare krahasuar me një vit më parë në masën 4,476.4 milionë lekë më shumë ose 5.4%. Shtesa e shpenzimeve është pasojë e efekteve financiare mbetëse të rritjes së pensioneve në vitin 2011, e efekteve financiare të rritjes së pensioneve për vitin 2012, si dhe e rritjes së numrit të përfituesve në skemat e pensioneve në vitin 2012 ndaj vitit 2011.

### Ecuria e volumit të transfertave në buxhetet familjare për periudhën 2009 - 2012

	2009	2010	2011	2012
Transferta në buxhetet e pensionistëve	72,339	77,837	83,665	88,141
Rritja në vlerë ndaj vitit të mëparshëm		5,498	5,828	4,476
Rritja në %		7.6	7.5	5.3

në milionë lekë

## Transfertat në buxhetet e pensionistëve nga sigurimi i detyrueshëm për periudhën 2006 - 2012



## 2. Zbatimi i buxhetit

Shpenzimet faktike në total për vitin 2012, krahasuar me programin, u realizuan në masën 99.6% ose nga 90,265 milionë lekë të programuara, u realizuan me 89,859.7 milionë lekë, me një mosrealizim prej rreth 405.3 milionë lekë.

Tabelë analitike mbi shpenzimet e vitit 2012

në milionë lekë

Shpenzime	Plan	Fakt	Ndryshimi	%
<b>1 Shpenzime për Përfitime</b>	<b>74,185</b>	<b>74,100</b>	<b>-84.8</b>	<b>99.9</b>
për sëmundje	379	381	2.2	100.6
për barrëllindje	2,084	2,076	-8.0	99.6
për pensione	71,708	71,632	-76.4	99.9
qytet	58,339	58,305	-33.8	99.9
fshat	13,369	13,326	-42.6	99.7
për aksidente dhe sëmund. Profesionale	14	11	-2.6	81.4
<b>2 Programe të tjera</b>	<b>9,159</b>	<b>9,062</b>	<b>-97.0</b>	<b>98.9</b>
pensione speciale e të posaçme	89	81	-7.1	92.0
invalidët e luftës dhe veteranët	378	363	-14.9	96.1
invalidët e punës	51	45	-5.1	89.9
kompensime	8,642	8,572	-69.9	99.2
<b>3 Shpenzime administrative</b>	<b>1,816</b>	<b>1,718</b>	<b>-97.8</b>	<b>94.6</b>
paga, shpërblym dhe shpenzime të tjera personale	887	855	-31.6	96.4
për sigurime shoqërore e shëndetësore	137	133	-4.5	96.7
mallra dhe shërbime të tjera	691	695	4.1	100.6
për rritjen e akv. të qëndrueshme të trupëzuara	101	35	-65.8	34.9
<b>4 Shpenzime për skema Suplementare</b>	<b>5,105</b>	<b>4,979</b>	<b>-125.8</b>	<b>97.5</b>
<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>90,265</b>	<b>89,860</b>	<b>-405.4</b>	<b>99.6</b>

Siç konstatohet edhe nga tabela e mësipërme, 98% të shpenzimeve totale të ISSH-së përbëhen nga transfertat në buxhetet familjare, të cilat janë edhe në fokusin kryesor të administrimit dhe të veprimtarisë drejtuese të ISSH-së. Ndërsa shpenzimet e administrimit nga 1,816 milionë lekë të programuara janë realizuar 1,718.3 milionë lekë, me një mosrealizim prej 97.7 milionë lekë ose 94.6%.

## 3. Bilanci të ardhura - shpenzime dhe rezultati financiar

Bazuar në realizimin faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve, rezultati financiar i ISSH-së për vitin 2012 rezulton me një tejkalim të shpenzimeve mbi të ardhurat në shumën 928 milionë lekë. Ky tejkalim është mbuluar në mënyrë të përkohëshme si nga rezervat monetare të krijuara në vitet e mëparshme, ashtu dhe nga gjendja e llogarive të kreditorëve.

në milionë lekë

Emërtimi	Plan	Fakt	në %
Të Ardhurat nga:			
kontribute të detyrueshme	47,314	45,726	96.6
kontribute suplementare	290	714	246.1
kontribute të bujkut	2,360	1,929	81.7
kontribute vullnetare	381	358	93.9
kontribute të tjera		11	
të ardhura të tjera	232	506	218.1
<b>Totali i të Ardhurave</b>	<b>50,577</b>	<b>49,244</b>	<b>97.4</b>
<b>Transferta nga buxheti i shtetit</b>	<b>39,688</b>	<b>39,688</b>	<b>100.0</b>
Shpenzime për:			
për përfitime	74,185	74,100	99.9
për programe të tjera	9,159	9,062	98.9
për shpenzime administrative	1,816	1,718	94.6
për skemën suplementare	5,105	4,979	97.5
<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>90,265</b>	<b>89,860</b>	<b>99.6</b>
Ndryshimi i gjëndjeve të materialeve	0	5.7	
<b>Rezultati Financiar</b>	<b>0</b>	<b>934</b>	



#### 4. Rezultati financiar për degën e pensioneve

Siç mund të konstatohet edhe më lart, pesha kryesore specifike në shpenzimet e fondit i takon degës së pensioneve, e cila është edhe dega bazë e sigurimit, ku personalizohet 21.6% e normës së përgjithshme të kontributit. Ndërsa degët e paftësisë, aksidenteve dhe barrë lindjeve rezultojnë me shpenzime të mbuluara nga kontributet, duke lënë edhe të ardhura të tjera të lira, dega e pensioneve vazhdon të jetë e pambuluar me të ardhurat kontributive të personalizuara, duke vazhduar të financohet me subveçione të Buxhetit të Shtetit. Për vitet 2011-2012 deficit i degës së pensioneve ka qenë rreth 1,4 % e PBB.

		2010	2011	2012	
A	Të ardhura nga kontributet për degën e pensioneve	000/lekë	52,774,398	54,763,938	57,497,339
B	Shpenzime për degën e pensioneve	000/lekë	64,998,385	68,803,306	78,028,033
	Difigiti në vlerë (A-B)	000/lekë	-12,223,987	-14,039,368	-20,530,694
	në % ndaj PBB	%	-0.99	-1.07	-1.48

Siç shihet dhe nga tabela, rezultati financiar i degës së pensioneve është përkeqësuar duke arritur aktualisht në 1.48 % të PBB, dhe kjo pasi të ardhurat e drejtpërdrejta për degën e pensioneve janë rritur nga viti në vit me ritmin 2-3%, megjithëse norma e kontributit në harkun e tre viteve është ulur me rreth 40% dhe shpenzimet janë rritur mesatarisht nga 7.6% në vitin 2010 deri 6.1% për vitin 2012 krahasuar me vitin paraardhës. Situata e treguesve kur deficit i jo vetëm që është mjaft i lartë por edhe vjen në rritje, dikton nevojën emergjente të ndërmarrjes së reformave për reduktimin e shpenzimeve të skemës, rritjen e të ardhurave të saj, përmirësimin e menaxhimit, si dhe për një reformë sistematike të skemave që administrojnë Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke synuar përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të sistemit, përmirësimin e infrastrukturës dhe të menaxhimit të fondit, si dhe vendosjen e një skeme pensionesh më të saktë, në mënyrë të tillë që gjithkush të jetë i interesuar për të kontribuar, duke pasur në këtë mënyrë përgjegjësi për të ardhurat në të ardhmen.

#### 5. Gjendja e aktiveve dhe pasiveve

Zbatimi i buxhetit dhe llogaria e ISSH realizohet në 14 njësi, nga të cilat 12 janë DRSSH, një njësi e zbatimit të buxhetit administrativ dhe një njësi e konsolidimit të marrëdhënieve financiare të ISSH-së me Thesarin e Shtetit, Bankën e Shqipërisë, Drejtoritë e Përgjithshme të Bankave të Nivelit të Dytë, si dhe ndërmjet buxhetit qendror dhe buxheteve rajonale. Mbi bazën e pasqyrave dhe raporteve të 14 qendrave të kostos, gjendja e aktiveve me datën 31.12.2012 krahasuar me vitin 2011 paraqitet:

Llogaritë e Aktivit	Ushtrim i mbyllur	Ushtrim i paraardhës	Ndryshimi
Aktive të Qëndrueshme	814,093	827,660	-13,567
Të patrupëzuara	5,998	31,784	-25,786
Të trupëzuara	808,095	795,876	12,219
Aktive Qarkulluese	14,614,159	14,776,030	-161,871
Kërkesa arkëtimi mbi Debitoret	7,170,158	7,306,972	-136,813
Llogaritë financiare	7,443,999	7,469,058	-25,059
Rezultati i Ushtrimit	944,963	24,608	920,355
<b>Totali i Aktivit</b>	<b>16,373,215</b>	<b>15,628,298</b>	<b>744,917</b>

në 000 lekë

në 000 lekë

Emërtimi i llogarive të pasivit	Ushtrim i mbyllur	Ushtrim i paraardhës	Ndryshimi
<b>FONDE TË VETA</b>	7,139,053	6,584,725	554,328
Fonde të veta	809,608	823,174	-13,567
Fonde të tjera të veta	3,899,416	3,899,416	0
Rezultati i mbartur	2,430,030	1,862,135	567,895
<b>DETYRIME</b>	7,446,672	7,117,998	328,674
Detyrime afatshkurtër	7,446,672	7,117,998	328,674
<b>LLOGARI TË TJERA</b>	1,776,232	1,397,788	378,444
<b>REZULTATI I USHTRIMIT</b>	11,259	527,787	-516,529
<b>TOTALI I PASIVIT</b>	<b>16,373,215</b>	<b>15,628,298</b>	<b>744,917</b>

Gjendja e aktivitetit në fund të vitit 2012, krahasuar me vitin 2011, rezulton me një shtesë prej 744.9 milionë lekë, megjithëse efekti kryesor është pasojë e deficitit financiar të vitit.



## 6. Ecuria e treguesve të performancës financiare të sistemit

Përsa i përket qëndrueshmërisë financiare të sistemit dhe ndikimit të tij në buxhetet familjare, me interes është shqyrtimi i ecurisë në vite i disa treguesve analitikë të sistemit, si norma e varësisë, shkalla e mbulimit, norma e zëvendësimit, niveli i përfitimeve ndaj PBB, etj.

- *Shkalla e mbulimit*, që shpreh raportin e numrit të kontribuesve ndaj forcave të punës, rezulton me rënie përkatësisht në periudhën 1994 - 1999. Më pas ky tregues ka një tendencë rritjeje, duke arritur nga 33% në vitin 1994 në 59% në vitin 2012. Ky tregues dëshmon për zvogëlimin e dukurisë së evazionit të kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore, i cili ka qenë një problem shqetësues. Ndërsa shpenzimet për sistemin e sigurimeve shoqërore në vitin 2012 arritën në masën 6.1% e PBB.
- *Norma e varësisë*, që shpreh raportin e përfituesve ndaj kontribuesve të skemës së sigurimeve shoqërore, është përkeqësuar nga vit në vit deri në vitin 2002, duke filluar me një përmirësim në vitin 2003 e në vazhdim, si rrjedhojë e rënies së ritmit të rritjes së numrit të pensionistëve dhe rritjes së numrit të kontribuesve. Për vitin 2012 ky koeficient është 0.85.
- *Norma e zëvendësimit*, e cila shpreh raportin midis pensionit dhe pagës:

pension mesatar i plotë i pleqërisë / pagë mesatare neto në qytet	49.1
pension mesatar i pleqërisë / pagë mesatare neto në qytet	46.4
pension mesatar i plotë i pleqërisë / pagë mesatare bruto në qytet	38.7
pension mesatar i pleqërisë / pagë mesatare bruto në qytet	36.5

Megjithëse një sërë treguesish të sistemit evidentohen mjaft të përmirësuar tashmë që gjendemi në vitin kur reforma e rritjes graduale të moshës së daljes në pension ka përfunduar, përsëri konstatohet një deficit i lartë i degës së pensioneve i cili arrin në 1.48% të PBB dhe me tendencë përkeqësimi.



## INFORMIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Realizimi i procesit të shpërndarjes së informacionit në kohë reale dhe me transparencë të plotë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore tek gazetarët e medias së shkruar dhe asaj vizive është konsideruar si një detyrë prioritare e këtij institucioni. Duke e parë informimin si një urë lidhëse midis ISSH-së dhe klientëve, gjatë vitit që lamë pas, ne jemi fokusuar qartazi në publikimin e çdo risije apo materiali informues në lidhje me shërbimet, detyrimet apo përfitimet që rrjedhin nga përfshirja e këtyre klientëve në skemën e sigurimeve shoqërore.

- Me rastin e 20 vjetorit të ngritjes së Institutit të Sigurimeve Shoqërore si një institucion më vete, në qershor të vitit 2012 u organizua Konferenca me temë “20 Vjet Institut i Sigurimeve Shoqërore”, në të cilën u evidentuan hapat e hedhur në këto 20 vite nga sigurimet shoqërore, si dhe sfidat në të ardhmen. Në konferencë, ku morën pjesë Ministri i Financave, z. Ridvan Bode, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z. Spiro Ksera, si dhe mjaft të ftuar të tjerë, mes të cilëve edhe Zv/Ministri i Punës dhe Mirëqënies Sociale në Kosovë z. Fatmir Shurdhaj, u shfaqën disa nga momentet më kryesore të ndryshimeve, të pasqyruara këto në buxhetet e shqiptarëve.

“20 vjetori i përket institucionit në formatin që funksionon sot, por përkujdesja për raportin social të sigurimeve shoqërore ka startuar së bashku me shpalljen e Pavarësisë, 100 vjet më parë, me krijimin e “Statusit Organik të Shqipërisë”, ku parashikoheshin edhe sigurimet shoqërore”, theksoi në fjalën e saj Drejtoresha e Përgjithshme e ISSH-së, znj. Vjollca Braho, e cila bëri një pasqyrë të ndryshimeve që ka pësuar ligji për sigurimet shoqërore, si dhe hapat aktualë të ISSH-së, ku më e rëndësishmja është siguria ndaj publikut se gjithkush do të mund të marrë çdo kontribut të paguar, shërbimi i drejtë dhe informatizimi i plotë i të dhënave. Znj. Braho përmendi disa nga ndryshimet më thelbësore që nga vitit 1993, mes të cilëve ajo në vitin 1995, ku u bënë ndryshimet e para në ligjin e sigurimeve shoqërore, i cili konsistonte në forcimin e kompetencave të inspektorëve të kontributeve.

Në vitin 1998 ndër të tjera, u saktësua që detyrimi për kontributet e papaguara të konsiderohej titull ekzekutiv. Gjithashtu, në fushën e përfitimeve, e drejta e marrjes së kësteve të patërhequra u shty nga 1 vit deri në 3 vjet, si dhe u miratua një skemë e re pensioni për fermerët. Në vitin 2001, për ta bërë më atraktive skemën, u riformuluan nenet për detyrimet e punëdhënësit, procedurat e regjistrimit në sigurimet shoqërore. Gjatë vitit 2002 realizuan këto ndryshime në legjislacion:

- së pari, u rrit raporti midis pagës minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve për sigurime shoqërore, nga 1/3 në 1/5;
- së dyti, u ul në masën 4% norma e kontributit për sigurimet shoqërore dhe, më kryesorja, u rritën në mënyre graduale moshat e daljes në pension pleqërie, për burrat e gratë, duke shkuar në moshën që është sot, 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë. Një vit më vonë, në vitin 2003, u bënë amendimet përkatëse që pasqyronin transferimin e shërbimit të mbledhjes së kontributeve nga organet e sigurimeve shoqërore tek organet e tatim-taksave, siç funksionojnë që prej vitit 2005. Gjithashtu, u bënë ndryshimet përkatëse në ligjin për pensionet suplementare private për futjen e fondeve profesionale të pensioneve.

Në vitin 2005 u realizua përqasja e legjislacionit shqiptar me standartet Europiane, Kodi Europian i Sigurimeve Sociale dhe Konventa e ILO-s për sigurimet shoqërore. Përsa i takon periudhës minimale për përfitim të pensionit të pjesshëm të pleqërisë (nga 20 vjet u bë 15 vjet). Në vitin 2006 u bë reduktimi i mëtejshëm i normës së kontributit, e cila vazhdonte të mbetej e lartë. ISSH-ja që nga ky vit e aktualisht është institucion që ka Ministri të linjës Ministrinë e Financave, ndërsa më parë ishte nën varësinë e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Në vitin 2007, u përcaktua shuma që duhet të kthejë personi kur ai ka përfituar të ardhura në mënyrë të paligjshme, kështu ai detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër duke ju mbajtur çdo muaj 50% e kestit mujor të përfitimit.


Në vitin 2009, u bë reduktimi i mëtejshëm i normës së kontributit, pjesa e punëdhënësit.

Në vitin 2011, duke marrë shkas nga disa trajtime gjyqësore dhe deri në Gjykatën Europiane të Drejtësisë në Strasburg, u ndryshua ligji i sigurimeve shoqërore, lidhur me mënyrën e konstituimit të KMGAP-ve, me qëllim sigurimin e pavarësisë në vendmarrje të Komisioneve Eprorë të Caktimit të Aftësisë për Punë.




- Instituti i Sigurimeve Shoqërore i është përgjigjur kërkesave gjithnjë e në rritje për krijimin e një sistemi sa më vizibël dhe bashkëkohor të informimit public, duke pasuruar dhe përditësuar në mënyrë periodike faqen zyrtare të ISSH-së, [www.isssh.gov.al](http://www.isssh.gov.al), me të gjitha aktivitetet apo informacionet e domosdoshme, të cilat lidhen direkt me funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore. Në faqen tonë të internetit janë pasqyruar në mënyrë të detajuar të gjitha aktivitetet më të rëndësishme të zhvilluara gjatë këtij viti si:


  - Konferenca me rastin e 20 vjetorit të ISSH - së, me temë "20 Vjet Institut i Sigurimeve Shoqërore";
  - Konferenca e organizuar nga Patronato INAS, CISL, me temë "Puna shqiptare në Itali, politika, përkujdesja e përfaqësimi";
  - "Konferenca kombëtare për moshimin dhe moshën e tretë", mbajtur më 30 korrik 2012;
  - Kongresi i Patronatit ACLI, i organizuar në Romë në datën 03.05.2012, në të cilin ishte i ftuar stafi i lartë drejtues i ISSH-së;
  - Takimi me temë "20 vjet emigracion shqiptar në Itali", i cili u organizua në Tiranë, nga Patronato INAS, CISL, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
- Vitin e kaluar, numri i klikimeve në faqen tonë zyrtare është rritur ndjeshëm, duke e çuar në 83,297 numrin e vizitorëve, nga 67,776 që ka qenë në 2011. Po t'i referohemi grafikut krahasues të numrit të vizitorëve për vitin 2011-2012, konstatohet se për vitin 2012 ka pasur rreth 15 600 vizitorë më shumë se në vitin 2011. Ndërkohë, nga grafiku i vizitorëve në linjë evidentohet se 57% janë vizitorë të rinj të faqes ndërsa 43% janë vizitorë që i janë rikthyer faqes.



Numri më i madh i klikimeve është bërë nga territori shqiptar (70,337), por klikime në rritje ka pasur dhe nga shtetet ku punojnë dhe jetojnë më shumë shqiptarë si Itali, Greqi, SHBA, etj.



- Gjatë vitit 2012, janë publikuar në median e shkruar rreth 788 artikuj mbi problematikat e ndryshme që ka paraqitur skema e sigurimeve shoqërore. Krahasuar me vitin 2011 evidentohet se janë botuar rreth 142 artikuj më shumë, si rezultat i rritjes së cilësisë dhe formave të shpërndarjes së informacionit nga specialistët tanë, si dhe interesit që kanë paraqitur çështje të ndryshme të skemës së sigurimeve shoqërore gjatë kësaj periudhe;



- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së posterave dhe fletëpalosjeve sensibilizuese për informimin e të gjithë klientëve tanë, në mënyrë të diferencuar, sipas target-grupeve që ato i përkasin, si dhe shpërndarjen e tyre në një sasi të konsiderueshme në të gjitha destinacionet ku ato ndodhen, ka qenë një tjetër rrugë e përafrimit të Institucionit tonë më njerëzit;
- Përdorimi me efektivitet i medias elektronike, nëpërmjet realizimit të një sërë emisionesh televizive, si një rrugë efektive e ISSH-së në drejtim të informimit të publikut dhe propagandimin e të gjitha shërbimeve, përfitimeve apo dhe detyrimeve të cilat rrjedhin si rezultat i përfshirjes në skemën e sigurimeve shoqërore.



## 20 VJET Institut i Sigurimeve Shoqërore

NUOTIM PËR SHITË | EJAË PËRSHËNDËTËSE | PUBLIKIME

ISSH në Shërbimin tuaj!



Rreth ISSH

Statistika

Marrëdhënie Nderkombëtare

Njoftime

Formularë

Abuzime të zbuluara

Lidhje

SSDP – Projekti i Shpërndarjes së Shërbimeve Sociale

Fjalori



Xeni 25 lektura online

### Mesazh përshëndetës i zonjës Vjollca Braho, Drejtore e Përgjithshme e Institutit të Sigurimeve Shoqërore



Ju uroj mirëseardhjen në faqen tonë. Kjo faqe është për Ju, ndaj dhe prania juaj është e rëndësishme për ne. Është e rëndësishme për të gjithë hapat që hedhim çdo ditë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj jush. Pikenisht për këtë fakt ne jemi të vendosur në bashkëpunimin me olinde që kërkon nga ne të ecim përpara, në të mirë të të gjithëve.

Kontributi i punës suaj kërkon nga ne përgjegjësinë për t'iu informuar në çdo moment dhe në çdo vend ku jetoni, dhe për t'iu dhënë në kohë atë që ju takon. Ne jemi sot përpara sfidës së madhe të dixhitalizimit të të dhënave, gjë që do të bëjë të mundur për sejin nga ju krijimin e logarive personale të kontributeve, e më pas edhe logaritjen automatike të përfitimeve për çdo qytetar.

Hedhja në këtë sistem i të gjithë të dhënave që kanë të bëjnë me vjetërsinë në punë të shtetasve shqiptarë dhe krijimin e regjistrit kombëtar të pensioneve është një sfidë që do të na japë mundësinë të jemi jo vetëm pranë jush, por edhe të garantojmë gjithsejllin se do t'iu logaritjet çdo kontribut i paguar dhe që askush nuk do të mundë të përfitojë pa të drejtë.

Shumë shpejt, gjithsejllin prej jush, do të mundet të aplikojë direkt në këtë faqe, duke hedhur një hap që do të na bashkojë me të gjithë familjen e madhe evropiane, ku dëshirojmë të jemi bashkëdhëtarë. Në këtë rrugëtim ne do të synojmë të shtojmë transparencën me kontribuesit dhe përfituesit e skemës, të japim informacion në kohë reale, përsa i përket marrëdhënies së tyre me ISSH-në, dhe pagimin e detyrimeve nga punëdhënësit, të jemi të shpejtë në lidhjen e përfitimeve si dhe mirëadministrimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, duke bërë kështu të mundur mirjen e besimit të gjithsejllin nga ju në skemën e pensioneve.

Anketimet e ndryshme na kanë bërë të besojmë se na keni ndjekur dhe ndihmuar, duke na orientuar drejt asaj që na bën më të besueshëm dhe më të komunikueshëm me ju. Ne do të vijojmë të japim informacione dhe të mirëpresim nga ju sugjerime për atë që mund të bëjmë më mirë.

Duke besuar se mendimet tuaja do të jenë një shtysë e rëndësishme në punën tonë, ne ju ftojmë në këtë bashkëdhëtim, që synon ta bëjë sa më të lehtë menaxhimin e kontributeve tuaja, duke bërë të mundur që përfitimi juaj të jetë në kohë dhe i merituar.

## e Pensione

### Pyetje & Përgjigje

**Pyetje 1** - Jam një qytetar që kam përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009. Për arsye ekonomike jam i detyruar të punësohem. Ju lutem më sqaroni nëse më ndërpritet pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

[më shumë](#)

**Pyetje 2** - Jam një qytetar me probleme shëndetësore. Plotësova dokumentacionin për të përfituar pension invaliditeti dhe u paraqita në KMCAP-in e rrethit, i cili më vlerësoi pa grup invaliditeti. Pas një periudhe kohe prej 4 muajsh nga vlerësimi i gjendjes shëndetësore nga KMCAP-i i rrethit, iu drejtova KMCAP-it Epror, pranë ISSH-së, për vlerësim të gjendjes shëndetësore. Por kërkesa ime



Për ju Emigrantë!


Arkiva ISSH



## ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Rekrutimi dhe menaxhimi me efikasitet i burimeve njerëzore janë elementët kyç për suksesin dhe mbarëvajtjen në punë. Progresi dhe rritja e vazhdueshme e Institutit të Sigurimeve Shoqërore bazohen pikërisht tek puna e një stafi të përzgjedhur me profesionalizëm të lartë. Kapitali njerëzor ka qenë dhe do të mbetet aseti më i çmuar. Për ne është shumë e rëndësishme që çdo person të orientohet siç duhet drejt pozicionit të punës, për të cilin ai është më i specializuar. Duke u bazuar në Strukturat Organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, Drejtorisë së Arkivit dhe DRSSH-ve, gjatë vitit 2012, ISSH përbëhej nga 1,219 punonjës definitivë dhe 245 punonjës me kontrata të përkohshme.

Në zbatim të Direktivës nr. 86/378/EEC "Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit shoqëror në punë" të Bashkimit Europian dhe Konventave Ndërkombëtare, në strukturën e përgjithshme administrative të sigurimeve shoqërore gjatë vitit 2012 është ndjekur parimi i trajtimit të barabartë të punësimit të femrave dhe meshkujve. Duke iu referuar strukturës administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, evidentohet qartë se punonjëset femra gjatë vitit 2012 kanë zënë rreth 60% të totalit të punonjësve në të gjitha DRSSH-të, si dhe në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së.



### Trajnimet


Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve institucionale janë realizuar aktivitete të ndryshme trajnuese për kualifikimin e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Gjatë vitit 2012, trajnimet janë zhvilluar në disa drejtime, si:

- Trajnimi afatgjatë i inspektorëve të të vetpunësuarve në bujqësi;
- Trajnimi i specialistëve të Informatikës në Institutin e Sigurimeve Shoqërore;
- Trajnimi afatgjatë i specialistëve të Statistikës dhe Aktuaristikës në ISSH dhe Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;
- Trajnimi afatgjatë i personelit të Administrimit të Përgjithshëm në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Gjithashtu, bashkëpunimet me Organizata Kombëtare dhe Ndërkombëtare si BB, ILO, PNUD, ITAP dhe OJF-të e ndryshme, kanë bërë të mundur realizimin e një sërë trajnimesh në nivele të larta drejtuese, brenda dhe jashtë vendit.



# Statistika të Sigurimeve Shoqërore 2012



## Statistika kryesore të sigurimeve shoqërore

Të ardhura nga kontributet*	Viti 2012	
	në milionë lekë	në përqindje ndaj totalit
nga skema e detyrueshme	56,598	98.7%
kontribute të personave juridikë e fizikë	48,610	84.8%
kontribute me destinacion nga Buxheti i Shtetit	7,988	13.9%
nga skemat suplementare	720	1.3%
<b>Totali i të ardhurave nga kontributet</b>	<b>57,318</b>	

<b>Totali i të ardhurave të ISSH / PBB</b>	<b>në përqindje</b>	<b>4.7%</b>
--	---------------------	-------------

Shpenzime	Viti 2012	
	në milionë lekë	në përqindje ndaj totalit
